PROCESVERBALI I MBLEDHJES DATE 27.03.2026

Sot në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Devoll zhvillohet mbledhja e radhës sipas njoftimit të datës 18.03.2026.

Të pranishëm në sallë:

Erolda Begolli, Festim Kaso, Oliver Mulla, Lindita Çokani, Paola Spaho, Vladimir Kello, Alfredi Gjata, Trifon Meraku, Esmeralda Medolli, Vladimir Gjyli.

Asnjëri nga këshilltarët nuk ka konflikt interesi.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 1 të rendit të ditës.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 2: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 27.02.2026

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 3, PV Nr 27 datë 18.03.2026 , " Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok ndihmën ekonomike për muajin Shkurt 2026

Nuk ka diskutime. (Në sallë vjen këshilltarja Valbona Spaho)

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 4, PV Nr 28 datë 19.03.2026 " Për miratimin e hartës së shërbimeve për të mitur në Bashkinë Devoll 2026-2027".

Zerina Sinani: Janë disa dokumenta strategjikë që duhet t'i kemi, përveç faktit tek pjesa e edukimit të fëmijëve, edhe nga ministria edhe nga rastet që kemi pasur na është kërkuar të kemi një hartë shërbimesh.

Oliver Mulla: Çfarë bëni në këtë rast?

Zerina Sinani: Përveç punëve të përditshme kemi dhe raste që na referohen nga shkollat, braktisje etj. Ne ndjekim rastin hap pas hapi për t'i ndihmuar dhe dhënë zgjidhje me sa mundësi kemi. Raste dhune etj.

Oliver Mulla: Si fillim është prindi ai që duhet të merret me edukimin e fëmijëve. Ka shumë raste që fëmijët shkojnë me thika në shkollë dhe fëmijë që zihen në oborret e shkollës. Problematikat më të mëdha këto janë: duhani, droga, thikat. Të paktën vendosni oficerë nëpër ambientet e shkollës për t'i parandaluar, apo t'u mbyllen dyert me çelës.

Trifon Meraku: Duke qenë se jam përditë aty si mësues i edukimit fizik dua të theksoj se ka shumë raste të tilla dhe diçka shqetësuese që është e përsëritur, thyerjen e derës te palestrës. Veprime jo normale për një nxënës shkolle.

Valbona Spaho: Nuk kemi asnjë lloj hapësire ligjore ku ne t'i përjashtojmë nxënësit, e dyta nuk kemi të drejtë të lëmë nxënësin pa arsimuar. Ne duhet të krijojmë kushte për të ardhur në shkollë. Nëse kërkohet mbyllja me çelës nuk e kam mundësinë pasi klasat dalin në orare të ndryshme për edukim fizik. Kush do të rrinte tek dera? Sistemi i sigurisë vendoset sipas numrit të nxënësve, nuk ka në çdo shkollë.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Eduard Duro: Për sa i përket dëmeve në shkolla nga nxënësit, t'i bëhet një procesverbal prindit dhe ta paguajë.

Alfredi Gjata: Vazhdonim me pikën 5, PV Nr. 29, datë 18.03.2026 "Për miratimin e listës së familjeve që do të trajtohen me subvencionim qiraje për vitin 2026."

Nuk ka diskutime.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 6, PV Nr. 30, datë 18.03.2026 "Për miratimin e përdorimit të transfertës të kushtëzuar akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirqënies Sociale dhe bashkëfinancimit të Bashkisë në formën e kontributeve në shërbime apo burime njerezore, për zbatimin e projektit "4 Rrota në Shërbim", viti i pestë i zbatimit per vitin 2026, dhe miratimin e buxhetit për këtë vit.

Nuk ka diskutime.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me PV Nr. 31, datë 18.03.2026 "Për miratimin dhe shpërndarjen e fondeve të papërdorura nga viti 2025.

Eduard Duro: Kam një propozim për një ndryshim të vogël: një pjesë e fondeve të akorduara për rikonstruksionin e ish-prefekturës të kalojnë tek ato rrugë që kanë nevojë për shpronësim. Duhet të fillojë procedura pak më parë, që të fillojë financimi për asfaltim.

Genti Demçolli: Cila është arsyeja e mos përdorimit të këtyre fondeve?

Eduard Duro: Gjithmonë ngelen fonde.

Genti Demçolli: Këtu janë edhe shërbimet; planifikimi që bën drejtorja përkatëse nuk e planifikon sa do t'i mbetet, por e planifikon vjetore. Gjithsesi e mora përgjigjen e pyetjes.

Në 200 punëtorë shërbimesh, sikur nga 1 të dalë në rrugë përditë, do të kishte ndryshime dhe mos të rrinin në kafene.

Eduard Duro: Ato që nuk u bënë në 30 vite, u bënë në 4 vite.

Hapet votimi: 11 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 8, PV Nr. 32, datë 18.03.2026 "Për disa ndryshime në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 81 , 25.11.2025" .

Nuk ka diskutime.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 9, PV 33, datë 18.03.2026 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 97, datë 26.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar të nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të Bashkisë Devoll për vitin 2026" .

Festim Kaso: Ky PV ka të bëjë vetëm me indeksimin sipas VKM?

Eduard Duro: Po.

Genti Demçolli: Po shikoj një rrogë të këshilltarit të kryetarit. Dua të di këta 3 këshilltarët cilët janë dhe çfarë bëjnë konkretisht që meritojnë këtë pagë?

Eduard Duro: Se për çfarë këshillohem unë me këshilltarët nuk raportoj dot tek ti. Mund të hysh online t'i kontrollosh, madje t'i takosh dhe live të marrësh opinion.

Hapet votimi: 10 pro, 0 kundër, 2 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me një PV Nr. 34 Datë 25.03.2026 " Miratimin e prioriteteve në investime për vitin 2026."

I cili nuk është i pasqyruar në rendin e ditës pasi është futur më mbrapa, por ka lidhje me PV 31, kështu që po e lexojmë tani.

Festim Kaso: Këto rrugët me këto emërtime nuk i marrim vesh as ku janë sipas emërtimeve që kanë.

Eduard Duro: Fatmirësisht i shkela vetë të gjitha para se t'ju sillja këtë PV.

Vladimir Kello: Pa ju futur në thelb investimeve që do të bëhen për sa i përket asfaltimit, unë kam kërkuar të asfaltohen dhe rrugët Bradvicë, Vidohovë, fshatrat.
Për mua këto emërtime janë paradoks. Si p.sh.: rruga "Xhamia", mund të vendosësh "Sheshi i Xhamisë".
Eduard Duro: Unë këto rrugë i kam gjetur me këto emra. Nëse ngremë një komision për ndryshimin e emrave, jam dakord.